



**Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo**  
**Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution**

---

## OPINION

### I

## AVOKATIT TË POPULLIT

**Ex officio nr. 295/2025**

*lidhur me monitorimin e mbarëvajtjes së Zgjedhjeve të Përgjithshme në Republikën e Kosovës, të mbajtura më 9 shkurt 2025*

Drejtuar:

Z. Kreshnik Radoniqi, Kryetar

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Prishtinë, 11 prill 2025

## Qëllimi

Ky opinion pasqyron qëndrimet dhe vlerësimet e Avokatit të Popullit lidhur me mbarëvajtjen e zhvillimit të procesit të zgjedhjeve të përgjithshme në Republikën e Kosovës, të mbajtura më 9 shkurt 2025.

Opinionin paraqet vlerësimet e Avokatit të Popullit mbi respektimin e të drejtave zgjedhore të qytetarëve, vlerësim ky i cili është bërë mbi bazën e informatave të mbledhura nga terreni gjatë monitorimit të procesit zgjedhor nga ekipet vëzhguese të Institucionit të Avokatit të Popullit, në ditën e zgjedhjeve.

## Baza kushtetuese dhe ligjore

1. Në pajtim me nenin 132, paragrafi 1, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.”* Kushtetuta më tej në nenin 135, paragrafi 3, përcakton: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*
2. Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
  - *“Për t’i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit” (neni 16, paragrafi 1);*
  - *“Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime qoftë për t’iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut” (neni 16, paragrafi 1);*
  - *“publikon raporte dhe bën rekomandime mbi politikat dhe praktikat për të luftuar diskriminimin dhe promovuar barazinë (neni 16, paragrafi 15);*
  - *“të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla” (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2);*
  - *“të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avansimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5);*
  - *“t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta” (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6).*
  - *“Avokati i Popullit mund t’i këshillojë dhe t’u rekomandojë autoriteteve të*

*Republikës së Kosovës për programet dhe politikat e tyre për të siguruar mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Kosovës” (neni 18, paragrafi 3).*

### **Instrumentet ligjore të aplikueshme**

3. E drejta për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur si e drejtë themelore civile dhe politike është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Neni 45 i Kushtetutës [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] përcakton që:

*“Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë. Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike.”*

4. Ligji nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës ka definuar çartë rregullat e organizimit të sistemit zgjedhor, duke përfshirë rregullat për përgatitjen, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen dhe shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

5. Neni 6 [E drejta për të votuar] i Ligjit nr. 08/L-228, saktëkton: *“Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë. E drejta e votës mund të kufizohet me vendim gjyqësor”.*

6. Lidhur me votimin brenda dhe jashtë vendit, ligji i lartpërmendur në nenin 7 [Votimi brenda dhe jashtë Kosovës], paragrafi 1 dhe 2 përcakton që: *“Çdo shtetas me të drejtë vote ka të drejtë të votojë në Kosovë në ditën e zgjedhjeve dhe në komunën ku ai apo ajo është i regjistruar, me kusht që emri i tij apo saj paraqitet në Regjistrin Qendror Civil. Shtetasi i Republikës së Kosovës, që jeton jashtë vendit, ka të drejtë të votojë në zgjedhje pas regjistrimit të suksesshëm sipas procedurave dhe afateve kohore të përcaktuara në këtë ligj”.*

7. Ligji në vijim, lidhur me të drejtën e votës dhe fshehtësinë e votës, në nenin 89, paragrafet 1, 5 dhe 6 parasheh se:

*“Votuesi më të drejtë për të votuar ka të drejtë vote nëse ai/ajo është i regjistruar në Kosovë ose ka aplikuar suksesshëm për votim jashtë Kosovës siç përcaktohet në nenet 6 dhe 7 të këtij ligji ..... Votuesi i cili është me aftësi të kufizuara në atë mënyrë që nuk është në gjendje të shënojë ose hedh fletëvotimin, mund të ndihmohet nga një person tjetër i zgjedhur nga votuesi, me kusht që personi që ndihmon është votues në qendrën e njëjtë të votimit me votuesin. Personi i tillë e ndihmon vetëm një votues dhe nuk është anëtar i KVV-së ose vëzhgues i akredituar, përjashtimisht për anëtarët e ngushtë të familjes. Për këtë lloj të votimit, KQZ do t’i caktojë kriteret me rregullën zgjedhore. Kryesuesi i Këshillit të vendvotimit obligohet që të shënojë në librin e votimit, rastet e votimit me asistencë, duke përfshirë arsyet konkrete dhe të shënojë të dhënat personale të votuesit dhe të dhënat personale të personit që ka ndihmuar.”*

8. E drejta e votës garantohet me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, e cila në nenin 21 parasheh:

*“ Secili ka të drejtë të marrë pjesë në qeverisjen e vendit të vet, drejtpërsëdrejti ose me anë të përfaqësuesve të zgjedhur lirisht. Secili ka njësoj të drejtë të hyjë në shërbimet publike të vendit të vet. Vullneti i popullit është bazë e pushtetit shtetëror; ky vullnet duhet të shprehet në zgjedhjet e herëpashershme dhe të lira, të cilat duhet të jenë të përgjithshme dhe me votë të barabartë, si dhe me votim të fshehtë ose sipas procedurës përkatëse të votimit të lirë.”*

9. Po ashtu, e drejta për zgjedhje të lira garantohet me nenin 3, të Protokollit shtesë 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila shprehimisht përcakton se: *“ Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të organizojnë në intervale të arsyeshme kohore, zgjedhje të lira me votim të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit për zgjedhjen e organit ligjvënës”*.

10. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 25, në pikën b, përkritazi me të drejtën për zgjedhje parasheh:

*“Çdo qytetar ka të drejtë dhe mundësi, që pa asnjë nga dallimet e përmendura në nenin 2 dhe pa kufizime të paarsyeshme: Të votojë dhe të zgjedhet gjatë zgjedhjeve të vërteta të herëpashershme, me votim të përgjithshëm dhe të barabartë dhe me vota të fshehta, të cilat sigurojnë shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve.”*

11. Sipas nenit 5, pika c, të Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial, shtetet duhet të eliminojnë diskriminimin racial në të gjitha format e tij dhe të garantojnë të drejtën e secilit për barazi përpara ligjit pa dallim race, ngjyre ose origjine etnike ose kombëtare, sidomos për të gëzuar të:

*“...drejtat politike, sidomos të drejtat e pjesëmarrjes në zgjedhje, e drejta e votimit apo e drejta për të qenë kandidat, sipas sistemit të votimit të përgjithshëm dhe të barabartë, e pjesëmarrjes në qeveri si dhe në drejtimin e punëve shtetërore, në të gjitha nivelet, dhe për të pasur hyrje të barabartë në shërbimet publike.”*

12. Trajtimi i barabartë dhe pa diskriminim sa i përket ushtrimit të të drejtave zgjedhore është e paraparë edhe me Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, e cila në nenin 7, pika a, garanton që:

*“Shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në jetën politike dhe publike të vendit dhe në mënyrë të veçantë u sigurojnë grave, në të njëjtat kushte me burrat, të drejtën: (a) Për të votuar në të gjitha zgjedhjet dhe referendumet publike si dhe për të qenë të zgjedhshme në të gjitha organet e zgjedhura publikisht.”*

13. Gjithashtu Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Protokollit Opsional, në Nenin 29 [Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike] garanton mbrojtjen e së drejtës për të zgjedhur dhe për tu zgjedhur ashtu që e njëjta parasheh që:

*“Shtetet Palë duhet tu garantojnë personave me aftësi të kufizuar të drejtat politike dhe mundësinë për t'i gëzuar ato njësoj si pjesa tjetër e popullësisë dhe duhet të marrin përsipër: (a) Tu garantojnë personave me aftësi të kufizuar pjesëmarrjen e plotë dhe efektive në jetën politike dhe publike njësoj si gjithë të tjerët, drejtpërsëdrejti apo nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, duke përfshirë edhe të drejtën dhe mundësinë e personave me aftësitë kufizuar për të votuar dhe për tu zgjedhur, ndër të tjera duke:*

- (i) Siguruar që procedurat, facilitetet dhe materialet e votimit të jenë të përshtatshme, të aksesueshme dhe të thjeshta për tu kuptuar dhe përdorur;
  - (ii) Mbrojtur të drejtën e personave me aftësi të kufizuar për të votuar me votë të fshehtë në zgjedhje dhe referendume publike, pa kërcënim, për të kandiduar në zgjedhje, për të ushtruar funksione publike dhe për të kryer të gjitha funksionet publike në të gjitha nivelet e qeverisë, duke lehtësuar përdorimin e teknologjive asistuese dhe të reja, ne rastet e përshtatshme;
  - (iii) Garantuar shprehjen e vullnetit të lirë të personave me aftësi të kufizuar si zgjedhës dhe për këtë qëllim, kur është e nevojshme, me kërkesën e tyre, lejohet asistenca në votim nga një person i zgjedhur prej tyre.
- (b) garantimin e një ambienti, në të cilin personat me aftësi të kufizuar mund të marrin pjesë në mënyrë efektive dhe të plotë në dirigjimin e çështjeve publike, pa diskriminim dhe njësoj si të tjerët dhe të inkurajojë pjesëmarrjen e tyre në çështjet publike, duke përfshirë:
- (i) Pjesëmarrjen në organizatat joqeveritare dhe shoqatat që kanë të bëjnë me jetën publike dhe politike në vend dhe në aktivitetet dhe administrimin e partive politike;
  - (ii) Krijimin apo pjesëmarrjen në organizata të personave me aftësi të kufizuar për të përfaqësuar personat me aftësi të kufizuar në nivele ndërkombëtare, kombëtare, rajonale dhe lokale. ”

#### **Monitorimi i procesit të zgjedhjeve të përgjithshme 2025 nga Institucioni i Avokatit të Popullit**

14. Avokati i Popullit, përmes përfaqësuesve të Institucionit të Avokatit të Popullit, të deleguar për ta monitoruar procesin e zgjedhjeve të përgjithshme në Republikën e Kosovës, ka monitoruar mbarëvajtjen e zgjedhjeve. Monitorimi, veçanërisht ka përfshirë aspektet:
- a) nëse procesi i votimit ka filluar me kohë;
  - b) nëse ka pasur raste që kanë cënuar rrjedhën normale të votimit;
  - c) nëse qendrat e votimit kanë pasur qasshmëri infrastrukture, veçanërisht për personat me aftësi të kufizuara;
  - d) identifikimin e votuesve në regjistrin e votuesve në vendvotime;
  - e) a janë respektuar rregullat e vendosjes së kamerave në vendvotime;
  - f) mbarëvajtja e procesit të vëzhgimit nga vëzhguesit;
  - g) ka pasur parregullsi në procesin e votimit;
  - h) a është respektuar ruajtja e fshehtësisë së votës dhe ruajtja e vullnetit elektoral të votuesve;
  - i) a janë respektuar të drejtat e votimit të personave me nevoja të veçanta;
  - j) mbarëvajtja e procesit zgjedhor në qendrat e ndalimit, të paraburgimit, burgjet, spitalet dhe shtëpitë e të moshuarve etj.
15. Duhet theksuar se Zyra Qendrore e Institucionit të Avokati i Popullit më 9 shkurt 2025, ka qenë e hapur për pranimin e ankesave fizike apo edhe nëpërmjet linjës telefonike, megjithëse nuk është pranuar ndonjë ankesë.

16. Në Prishtinë dhe rrethinë procesi zgjedhor është monitoruar në qendrat e votimit si në vijim: qendra e votimit nr. 1902; qendra e votimit nr. 1914; qendra e votimit nr.1916; qendra e votimit nr.1917; qendra e votimit nr.1927; qendra e votimit nr.1911; qendra e votimit nr.1918; qendra e votimit nr. 1903; qendra e votimit nr. nr.1909; qendra e votimit në Sallën "1 Tetori"; qendra e votimit nr. .1906; qendra e votimit nr. 1930; qendra e votimit nr. 1904; qendra e votimit nr. nr.1912 si dhe Shtëpia për Përkujdesje të të Moshuarve në Prishtinë; qendra e votimit nr.1923; qendra e votimit nr.1929; qendra e votimit nr.1921; qendra e votimit nr.1922; qendra e votimit nr.1919; qendra e votimit nr.1935 në Bardhosh; qendra e votimit nr.1936 në Besi; qendra e votimit nr.1947 në Vranidoll; qendra e votimit nr.1946 në Bërnice e Poshtme; qendra e votimit nr. 1913; qendra e votimit nr. 1916; qendrën e votimit nr. 1942 në fshatin Llukar; qendra e votimit nr. 1943 në fshatin Koliq; qendra e votimit nr. 1941 në fshatin Sharban; qendra e votimit nr. 1944 në fshatin Keqekollë; qendrën e votimit nr.1945 në fshatin Dabishevc; qendra e votimit nr. 1950, në fshatin Rimanishtë; qendra e votimit nr. 1952, në fshatin Busi; qendra e votimit nr. 1949, në fshatin Shashkofc; Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK); Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë (QPP); qendra e votimit nr.1932 -vendvotimet 03, 04 dhe 05 në Hajvali; qendra e votimit nr.1931 - vendvotimet 02, 03 dhe 04 në Matiqan; qendra e votimit nr.1939/01në Fshatin Slivovë; qendra e votimit nr. 1954 në Hajvali; qendra e votimit nr. 1940/01 në fshatin Marec; qendra e votimit nr. 1938 në fshatin Mramor - vendvotimet 01 dhe 02.

Çështjet e evidentuara gjatë monitorimit në Komunën e Prishtinës: *Në përgjithësi procesi vlerësohet se ka kaluar i qetë dhe pa incidente. Qendrat e votimit ishin hapur me kohë dhe ishin furnizuar me material të nevojshëm. Qendrat e votimit kanë pasur kamera të vendosura në distancën e lejuar. Qendrat e votimit kryesisht kanë qenë të qasshme në aspektin infrastrukturor, me përjashtim të së paku 5 qendrave që nuk kanë pasur qasje adekuate për persona me aftësi të kufizuara apo persona të moshuar. Kryesisht qendrat e votimit kanë poseduar fletvotime në alfabetin Braille, me përjashtim të vetëm disa qendrave. Përjashtimisht në disa vendvotime në hyrjen e objektit ka munguar shënimi për numrin e qendrës së votimit. Personat që kishin nevojë për ndihmë gjatë votimit u shoqëruan sipas rregullave. Po ashtu, në disa qendra të votimit është evidentuar mungesë edhe të tavolinave ndihmëse. Në një rast sipas informatave të pranuar nga një qytetar, fletvotimi në Braille nuk ka qenë në përputhje me fletvotimin tjetër të zakonshëm. Në afërsisht 5 qendra të votimit është raportuar për mungesë të furnizimit me kartela identifikuese – begja për stafin e përcaktuar për menaxhimin e organizimit të qendrës së votimit. Në dy qendra të votimit janë hasur shenjzime të Listës së kandidatëve me subjekte politike, të cilët janë zëvendësuar pas reagimit të zyrtarëve të IAP-së. Ndërsa në Shtëpinë për Përkujdesje të të Moshuarve votimi ka filluar në pjesën e dytë të ditës, ku kjo qendër është vizituar dy herë nga ekipet e IAP-së dhe se procesi i votimit është raportuar se ka shkuar në rregull. Sa i përket votimit në klinikat e QKUK-së, ekipet e IAP-së janë njoftuar se për votim janë regjistruar 395 pacientë të shtrirë për të votuar, përfshirë 21 pacientë të shtrirë në Institutin e Psikiatrie Forenzike. Procesi i votimit është zhvilluar përmes ekipeve mobile të KQZ-së dhe është evidentuar se procesi ka shkuar me rregull. Po ashtu edhe në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë procesi i votimit është zhvilluar nëpërmjet një ekipi mobil të KQZ-së. Sipas të dhënave të siguruar nga ekipi mobil i KQZ-së, janë regjistruar gjithsej 229 persona të privuar nga*

*liria për të votuar. Ambienti i votimit ka qenë i qetë dhe procesi po zhvillohej pa pengesa.*

17. Në Graçanicë dhe në Lipjan procesi zgjedhor është monitoruar në qendrat e votimit si në vijim: qendra e votimit nr. 3407 (vendvotimi 01 dhe 02); qendra e votimit nr. 1305 (vendvotimi 01,02,03,04) në Janjevë; qendra e votimit nr. 3405 (vendvotimi 01,02,03) në Gushtericë të Poshtme ; qendra e votimit nr. 3410/01 në Dobrotin; qendra e votimit nr.3402 (vendvotimi 01,02 I 03) në Llapnasellë; qendra e votimit për votim me kusht 3401 VK); qendra e votimit nr. 3406 (vendvotimet 01 dhe 02) në Lepina; qendra e votimit nr. 3408/01 në Preoc; qendra e votimit nr. 3411/01 në Suhadoll si dhe qendra e votimit nr. 3401 (gjithsej 9).

*Çështjet e evidentuara gjatë monitorimit në Komunën e Graçanicës dhe Lipjanit: Në përgjithësi në qendrat e votimit të monitoruara nga IAP në Graçanicë dhe në Lipjan procesi ka vijuar i qetë dhe i sigurt. Qasja infrastrukturore në objekte të votimit ka qenë e përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara, me përjashtim të një qendre të votimit. Po ashtu qendrat e votimit kanë pasur në dispozicion fletvotimet në alfabetin Braille. Kamerate e sigurisë kanë qenë të instaluara, votimi realizohej në mënyrë të fshehtë, dhe nuk është hasur në ndonjë situatë me ndikim në vullnetin politik të qytetarëve. Në qendrën e votimit në Janjevë është evidentuar se janë respektuar rregullat për vendosjen e kamerave, por është konstatuar se 2 kamera nuk funksiononin. Përjashtimisht në këtë qendër është hasur në një rast të shenjzimit të Listës së kandidatëve me subjekte politike, e cila është zëvendësuar pas reagimit të zyrtarëve të IAP-së.*

18. Në Pejë procesi zgjedhor është monitoruar në qendrat e votimit si në vijim: qendra e votimit nr. 1701 – 7 vend votime; qendra e votimit nr. 1705 - 11 Vend Votime; qendra e votimit nr. 1708; qendra e votimit nr. 1704 – 13 vend votime; qendra e votimit nr. 1702 – 8 vend votime; qendra e votimit nr. 1719 - Gorazhdec/Peje; qendra e votimit nr. 1710; qendra e votimit nr. 1706; qendra e votimit nr. 1701 VK/ 2 VV; qendra e votimit nr. 1711 në Novosellë; qendra e votimit nr. 1707- 7 vend votime; qendra e votimit nr. 1706 - 8 vend votime; qendra e votimit nr. 1709 - 9 vend votime.

*Po ashtu është monitoruar edhe Qendra e Paraburgimit në Pejë, Qendra Integruese në Bashkësi si dhe Spitali Regjional në Pejë. Ndërsa Qendra e Votimit 7 Shtatori në Vitomiricë të Pejës edhe pse figuronte në listën e KQZ-së, kjo shkollë ka qenë e mbyllur.*

19. Në Istog procesi zgjedhor është monitoruar në qendrat e votimit si në vijim: Qendra Korrektuese në Dubravë 06/04/02, me 3 vend votime; qendra e votimit nr. 0601-vendvotim me kusht; qendra e votimit nr. 0601; qendra e votimit nr. 0604 në Gurrakoc; qendra e votimit nr. 0604 – 5 vend votime në Gurrakoc; qendra e votimit nr. 0606 në Vrellë – 5 vend votime; SHFMU “ Trepça” në Banjë të Pejës në Istog – 7 vend votime; si dhe Shtëpia e Komunitetit për Persona të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Gurrakoc të Istogut.

*Çështjet e evidentuara gjatë monitorimit në Komunën e Pejës dhe të Istogut: *Procesi vlerësohet se ka qenë i qetë dhe pa incidente. Kryesisht është evidentuar për mungesë të materialeve informuese nga KQZ në tavolinat ndihmëse si dhe në tre vendvotime nuk është lejuar votimi me asistencë. Është evidentuar mungesë e tavolinës ndihmëse në qendrën e votimit në Gorazhdec. Sa i përket Qendrës Integruese në Bashkësi në Pejë,**

ekipi i IAP gjatë vizitës në këtë qendër është njoftuar se qendra ka 9 rezidentë me të drejtë vote, por të cilët nuk kanë mundur të votojnë, për arsye se nuk janë vizituar nga ekipet e KQZ me qëllim të votimit. Në Qendrën Korrektuese në Dubravë, sipas informatave të siguruara me të drejtë vote janë evidentuar 538 persona nga 646 persona sa ishin prezent dhe procesi ishte zhvilluar me rregull. Kamerat edhe pse ishin instaluar në të gjitha vendvotimet, ato nuk ishin në pozicione të njejta. Të paktën katër qendra të votimit ishin të paqasshme në aspektin infrastrukturor.

21. Në Gjakovë procesi zgjedhor është monitoruar në qendrat e votimit si në vijim: qendra e votimit nr. 0208 - vendvotimi 01, 06, dhe 08; qendra e votimit nr. 0201- vendvotimi 03 dhe 06; qendra e votimit nr. 0211- vendvotimi 01 dhe 03; qendra e votimit nr. 0228 - vendvotimi 01 dhe 03; qendra e votimit nr. 0224 - vendvotimi 01; qendra e votimit nr. 0226 - vendvotimet 01 dhe 03; qendra e votimit nr. 0201VK - vendvotimet 01 dhe 02; qendra e votimit nr. 0205 - vendvotimet 02 dhe 04; qendra e votimit nr. 0203- në vendvotimet 01, 03 dhe 04; Spitali i Përgjithshëm "Isa Grezda" në Gjakovë dhe Shtëpia e Integruar në Bashkësi në Gjakovë.

Çështjet e evidentuara gjatë monitorimit në Komunën e Gjakovës: Në përgjithësi edhe në këtë komunë procesi ka vijuar të jetë i qetë. Megjithatë është vërejtuar se në disa qendra të votimit ka munguar qasja adekuate infrastrukturore për personat e moshuar dhe për persona me aftësi të kufizuara, po ashtu ka pasur paqartësi rreth kushteve për lejimin e votimit me asistencë, ku në disa raste votuesit ishin lejuar dhe në disa raste jo pa fletdëshmi mjekësore. Gjithashtu edhe lartësia e vendosjes së kamerave në disa qendra të votimit është vërejtur të jetë jashtë standardit të lejuar. Sipas informatave të siguruara, në Spitalin e Përgjithshëm "Isa Grezda" në Gjakovë, në Repartin e Emergjencës dhe në Repartin e Njësisë Koronare ekipi mobil i KKZ-së kishte dalë në votime dhe pacientët kishin votuar. Po ashtu ekipet mobile kanë qenë prezente edhe në Shtëpinë e Integruar në Bashkësi në Gjakovë dhe të gjithë rezidentët kishin votuar.

22. Në Deçan dhe në Junik procesi zgjedhor është monitoruar në qendrat e votimit si në vijim: qendra e votimit nr. 0107 - vendvotimet 01, 02 dhe 03; qendra e votimit nr. 0108 - vendvotimet 01 dhe 02; qendra e votimit nr.0101 - vendvotimet 02 dhe 05 dhe qendra e votimit nr. 0101 VK - vendvotimin 01 në Deçan; qendra e votimit nr. 3101 - vendvotimet 01, 04 dhe 07 dhe qendra e votimit nr.3101 VK - vendvotimin 01 në Junik.

Çështjet e evidentuara gjatë monitorimit në Komunën e Deçanit dhe të Junikut: Në përgjithësi edhe në këto komuna procesi ka vijuar të jetë i qetë. Paqartësia lidhur me kushtet për lejimin e votimit me asistencë, ku në disa raste votuesit ishin lejuar të votojnë, dhe në disa raste jo pa fletdëshmi mjekësore, ka qenë shqetësim prezent edhe në këto komuna.

23. Në Mitrovicën Jugore procesi zgjedhor është monitoruar në qendrat e votimit si në vijim: qendra e votimit nr. 1104/01; qendra e votimit nr. 1101; qendra e votimit nr. 1103; qendra e votimit nr. 1108; qendra e votimit nr. 1106; qendra e votimit nr. 1122; qendra e votimit nr. 1102; qendra e votimit nr.1120; qendra e votimit nr. 1103; qendra e votimit nr. 1123; qendra e votimit nr. 1129; qendra e votimit nr. 1124.

Çështjet e evidentuara gjatë monitorimit në Komunën e Mitrovicës Jugore: Në të paktën tri qendra të votimit është hasur në problemin e qasshmërisë infrastrukturore për

*personat me aftësi të kufizuara dhe persona të moshuar. Ndërkaq po ashtu është evidentuar se në disa vendvotime ka munguar tavolina ndihmëse me informata relevante.*

24. Në Vushtrri procesi zgjedhor është monitoruar në qendrat e votimit si në vijim: qendra e votimit nr. 2703 - Qendra Korrektuese në Smrekonicë; qendra e votimit nr. 2702; qendra e votimit nr. 2701; qendra e votimit nr. 2703; qendra e votimit nr. 2704; qendra e votimit nr. 2707; qendra e votimit nr. 2727; qendra e votimit nr. 2714.

*Çështjet e evidentuara gjatë monitorimit në Komunën e Vushtrisë: Në të paktën në një qendër të votimit është hasur problemi i qasshmërisë infrastrukturore për personat me aftësi të kufizuara, e po ashtu në disa vendvotime ka munguar tavolina ndihmëse me informata relevante. Fletvotimet në alfabetin Braille kanë qenë të disponueshme në pothuajse të gjitha qendrat e vëzhguara, ndërkaq procesi në përgjithësi ka shkuar mirë. Në Qendrën Korrektuese në Smrekonicë në përgjithësi rrjedha e procesit të zgjedhjeve ishte zhvilluar me rregull.*

25. Në Prizren procesi zgjedhor është monitoruar në qendrat e votimit si në vijim: qendra e votimit nr.2001; qendra e votimit nr. 2008 – 8 vend votime; qendra e votimit nr. 2047 - 7 vendvotime; qendra e votimit nr. 2002; qendra e votimit nr. 2007; qendra e votimit nr. 2022 në fshatin Lubizhdë - 5 vendvotime; qendra e votimit nr. 2042 në fshatin Zhur – 3 vend votime si dhe qendra e votimit nr. 20/01/01 – Qendra e Paraburgimit në Prizren. Në Dragash janë monitoruar: qendra e votimit me kusht 0501/01VK në Dragash – 2 vendvotime; qendra e votimit nr.0501 në Dragash.

*Çështjet e evidentuara gjatë monitorimit në Komunën e Prizenit dhe të Dragashit: Në shumicën e vendvotimeve është vërejtur se nuk kishte tavolina ndihmëse. Jo të gjitha vendvotimet ishin të pajisura me material në Braille. Edhe pse në shumicën e vendvotimeve kishte pjerrina përmes së cilave mundësohej qasje për persona me aftësi të kufizuar, janë vërejtur se disa vendvotime ishin të paqasshme për personat e moshuar dhe personat me aftësi të kufizuar. Nga vet stafi i angazhuar në vend votime është ngritur shqetësimi për mungesë të kartelave identifikuese - begjave për komisionerë. Kishte mungesë të pajisjeve/tabletve për mbledhjen e statistikave për moshën dhe gjininë e votuesve, dhe të tilla shënime evidentoheshin në letër A4. Vërehej praktikë jo e unifikuar e votimit me asistencë, diku kërkohet dëshmia mjekësore dhe diku jo. Në vendvotimet në Dragash mungonin shenjat orientuese në qendrat e votimit. Në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, nga 70 të paraburgosur, të regjistruar për votim janë evidentuar 66. Gjatë monitorimit të procesit të votimit, fillimisht është vërejtur se KQZ nuk e ka sjellur materialin e kompletuar dhe sipas komunikimit të mëvonshëm me qendrën, ekipet e IAP-së janë njoftuar se votimi në këtë qendër ka filluar në ora 11:00 dhe procesi kishte shkuar me rregull.*

26. Në Malishevë procesi zgjedhor është monitoruar në qendrat e votimit si në vijim: qendra e votimit nr. 3011; qendra e votimit nr. 3015; qendra e votimit me nr. 3001; qendra e votimit me nr. 3001; qendra e votimit me nr. 3010; qendra e votimit me nr. 3025; qendra e votimit me nr. 3017.

Në Klinë procesi zgjedhor është monitoruar në qendrat e votimit si në vijim: qendra e votimit me nr. 0808; qendra e votimit me nr. 0801; qendra e votimit me nr. 0802.

Në Skënderaj procesi zgjedhor është monitoruar në qendrat e votimit si në vijim: qendra e votimit me nr. 2118; qendra e votimit me nr. 2125; qendra e votimit me nr. 2116; qendra e votimit nr. 2101; qendra e votimit me nr. 2101 VK; qendra e votimit me nr. 2102.

Në Drenas procesi zgjedhor është monitoruar në qendrat e votimit si në vijim: qendra e votimit nr. 0303 dhe qendra e votimit nr. 0302

Çështjet e evidentuara gjatë monitorimit në Komunën e Malishevës, Klinës, Drenasit dhe Skënderajit: *Kryesisht është vërejtur se procesi ka shkuar me rregull, ku qendrat e votimit kanë qenë të pajisura me material e poashtu me fletvotime në Braille. Vendvotimet kanë qenë të qasshme për personat me aftësi të kufizuara, me disa përjashtime në Komunën e Klinës. Në dy vendvotime në Komunën e Klinës është vërejtur shenjëzimi i listës me subjektet e partive politike dhe kandidatëve, e cila situatë është raportuar dhe të njëjtat janë zëvendësuar. Qendrat e votimit kanë qenë të pajisura me kamera.*

27. Në Suharekë procesi zgjedhor është monitoruar në qendrat e votimit si në vijim: qendra e votimit nr. 2425 - vendvotimi 01 dhe 02 në Duhël; qendra e votimit nr.2401 - vendvotimi 01, 02, 03, 04, 05, 06, 07, 08; qendra e votimit nr.2402 - vendvotimi 01, 02, 03; qendra e votimit nr.2418 - vendvotimi 01, 02, 03, 04 në fshatin Studençan.

Në Mamushë procesi zgjedhor është monitoruar në qendrat e votimit si në vijim: qendra e votimit nr. 3201 - vendvotimi 01, 02, 03, dhe vendvotimi me kusht 01.

Në Rahovec procesi zgjedhor është monitoruar në qendrat e votimit si në vijim: qendra e votimit nr. 1601 - vendvotimi 01, 02, 03; qendra e votimit nr. 1601-VK 01; qendra e votimit nr. 1602 - vendvotimi 01 dhe 02; qendra e votimit nr. 1605 - 10 vendvotime; qendra e votimit nr. 1606 - vendvotimi 01.

Çështjet e evidentuara gjatë monitorimit në Komunën e Suharekës, Mamushës dhe Rahovecit: *Në përgjithësi është vërejtur se qendrat e votimit kanë pasur shenjat dalluese që e identifikojnë lehtësisht atë qendër të votimit me disa përjashtime të vogla. Ambienti ka qenë i qetë dhe i sigurtë për votim. Fletvotimet në afabetin Braille nuk e kanë poseduar jo të gjitha qendrat e vëzhguara, në disa qendra të votimit mungonin. Qajsa për personat me aftësi të kufizuara në shumicën e qendrave ka qenë e lehtë, në përjashtim të atyre QV që kishin votues edhe në katin e dytë dhe aty qasja është evidentuar si e vështirë. Tavolinat ndihmëse kanë munguar në pothuajse shumicën e qendrave të votimit. Edhe në këto qendra problematike qëndronte votimi me asistencë pa dëshmi mjekësore dhe nuk kishte praktikë të unifikuar të zbatimit të rregullit.*

28. Në Ferizaj procesi zgjedhor është monitoruar në qendrat e votimit si në vijim: qendra e votimit nr.2527; qendra e votimit nr. 2512; qendra e votimit nr. 2543; qendra e votimit nr. 2515; qendra e votimit nr. 2502; qendra e votimit nr. 2501; qendra e votimit nr. 2501VK; qendra e votimit nr. 2506; qendra e votimit nr. 2507; qendra e votimit nr. 2508. Po ashtu është monitoruar edhe Shtëpia Integruese në Bashkësi si dhe Qendra e Ndalimit në Ferizaj.

Në Shtërpçë procesi zgjedhor është monitoruar në qendrat e votimit si në vijim: qendra e votimit nr. 2302; qendra e votimit nr. 2305.

Në Kaçanik procesi zgjedhor është monitoruar në qendrat e votimit si në vijim: qendra e votimit nr. 0701; qendra e votimit nr. 0703.

Në Han të Elezit procesi zgjedhor është monitoruar në qendrat e votimit si në vijim: qendra e votimit nr. 3301.

Çështjet e evidentuara gjatë monitorimit në Komunën e Ferizajit, Shtërpcës, Kaçanikut dhe Hanit të Elezit: *Përgjithësisht procesi i zgjedhjeve sipas vëzhgimit vërehet se është realizuar në një ambient të sigurt dhe të qetë. Qendrat e votimit kanë poseduar shenja dalluese që e identifikojnë lehtësisht qendrën e votimit. Është evidentuar mungesë e tavolinave ndihmëse në qendrat e votimit, e po ashtu edhe fletvotimet në Braille nuk i kanë poseduar shumë qendra të votimit. Sa i përket Shtëpisë Integruese në Bashkësi, ku kanë qenë të regjistruar 10 persona për votim, deri në kohën kur ekipet e IAP-së kanë monitoruar procesin nuk është zhvilluar votimi. Më vonë sipas informatave që IAP ka pranuar nga KKZ në Ferizaj është njoftuar se edhe pse informatat e nevojshme u janë përcjellur KQZ-së, nga kjo e fundit nuk është marrë asnjë instruksion apo udhëzim për veprim lidhur me mundësimin e votimit të tyre. Në Qendrën e Ndalimit në Ferizaj, është mësuar se nuk ka pasur persona të ndaluar, për shkak se qendra gjindej në fazën e renovimit.*

29. Në Gjilan procesi zgjedhor është monitoruar në qendrat e votimit si në vijim: qendra e votimit nr. 0401 - vendvotimi nr. 01; qendra e votimit nr. 0402 – vendvotimi nr.03; qendra e votimit nr. 0404 – vendvotimi nr.02; qendra e votimit nr. 0407 – vendvotimi nr.02; qendra e votimit nr. 0403 – vendvotimi nr. 02 dhe 03; qendra e votimit nr. 0410 – vendvotimi nr. 01,03 dhe 04; qendra e votimit nr. 0414 – vendvotimet nr. 01 dhe 03 në fshatin Malishevë; qendra e votimit nr. 0414 në fshatin Uglar - vendvotimet nr. 01 dhe 02; qendra e votimit nr. 0419 në fshatin Kmetoc - vendvotimi nr. 01; qendra e votimit nr. 0419 në fshatin Përlepnice - vendvotimi nr. 01 dhe 03 si dhe dhe Qendra e Paraburgimit në Gjilan.

Çështjet e evidentuara gjatë monitorimit në Komunën e Gjilanit: *Përgjithësisht procesi i votimit zhvillohej në një ambient të qetë dhe të sigurt. Megjithatë si problem i përbashkët në shumicën e këtyre qendrave është vërejtur mungesa e broshurave dhe fletvotimeve në alfabetin Braille si dhe mungesa e tavolinave ndihmëse. Sa i përket Qendrës së Paraburgimit në Gjilan, procesi i votimit kishte filluar në ora 11:37 për shkak të disa vonesave teknike dhe administrative. Në këtë qendër po ashtu procesi ka shkuar me rregull, ndërsa 4 (katër) personave nuk iu është lejuar votimi për shkak se nuk gjendeshin në listën e votuesve.*

30. Në Viti procesi zgjedhor është monitoruar në qendrat e votimit si në vijim: qendra e votimit nr. 2602 - vendvotimet nr. 01 dhe 02; qendra e votimit nr. 2602 – vendvotimi me kusht nr. 01; qendra e votimit nr. 2609 në fshatin Radivojc - vendvotimet nr. 01 dhe 02.

Çështjet e evidentuara gjatë monitorimit në Komunën e Vitisë: *Përgjithësisht në këto qendra të votimit procesi kishte vijuar me rregull. Personat me aftësi të kufizuar kishin qasje pasi që vendvotimet ishin në katin e parë. Një rast i hasur i shenjëzimit të listës së subjekteve politike dhe kandidatëve është raportuar, si dhe është vërejtur mungesë e tavolinave ndihmëse në qendrat e votimit.*

31. Në Klllokot, Partesh dhe Ranillug procesi zgjedhor është monitoruar në qendrat e votimit si në vijim: qendra e votimit nr. 3701 - vendvotimet nr. 01 dhe 02 në Klllokot; qendra e votimit nr. 3701 - vendvotimet nr. 01 dhe 02 në Partesh; qendra e votimit nr. 3502 - vendvotimet nr. 01 dhe 02 në Ranillug.

Çështjet e evidentuara gjatë monitorimit në Komunën e Klllokotit, Parteshit dhe Ranillugut: *Përgjithësisht në këto komuna, procesi i votimit është evidentuar se kishte vijuar me rregull.*

32. Në Shtime dhe Lipjan procesi zgjedhor është monitoruar në qendrat e votimit si në vijim: Qendra Integruese Rehabilituese e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik në Shtime; qendra e votimit nr. 2202 - vendvotimet 01, 02 dhe 03; qendra e votimit nr.2208 në Godanc; qendra e votimit nr. 2205 në Reçak; qendra e votimit nr. 2204 në Petrovë. Ndërsa në Lipjan janë monitoruar qendrat e votimit: qendra e votimit 13/01 - Qendra Korrektuese për të Mitur në Lipjan; Qendra Korrektuese për Femra në Lipjan, nr.13/01; qendra e votimit nr. 1303; qendra e votimit nr. 1302; qendra e votimit nr. 1301; qendra e votimit nr. 1330; qendra e votimit nr. 1313; qendra e votimit nr. 1322/01, në fshatin Rufe i Ri.

Çështjet e evidentuara gjatë monitorimit në Komunën e Shtimes dhe të Lipjanit: *Përgjithësisht në këto qendra të votimit procesi kishte filluar me kohë. Megjithatë në shumicën e qendrave të votimit nuk ka pasur shenja dalluese që e identifikojnë lehtësisht qendrën e votimit. Jo të gjitha qendrat e votimit kishin qasshmërinë infrastrukturore për personat me aftësi të kufizuara dhe persona të moshuar. Në disa qendra të votimit kanë munguar fletvotimet në alfabetin Braille, si dhe tavolinat ndihmëse. Qendrat e votimit kanë pasur kamera të vendosura. Në Qendrën Integruese Rehabilituese e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik në Shtime (QIRSKP), rezidentëve nuk i`u është mundësuar e drejta e votimit. Në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan, përgatitjet e duhura janë bërë me kohë, kanë qenë prezentë masa të arsyeshme të sigurisë për të garantuar ambient të sigurt dhe të qetë të votimit. Disa nga të burgosurit nuk kanë mundur të votojnë për shkak se nuk kanë qenë të evidentuara në listë për votim. Disa të mitur të burgosur, kanë votuar me asistencë, për arsye se nuk dinin shkrim-lexim (3 të mitur).*

*Në Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan votimi kishte filluar në orën 11:40. Sipas informatave të siguruar nga zyrtarë të qendrës, prej 28 të burgosurave, 19 kanë qenë në listë për të votuar, 4-5 nuk kanë qenë të pajisura me dokumente identifikimi dhe tri kanë refuzuar votimin. Dy të burgosura nuk kanë mundur të votojnë për shkak se nuk kanë qenë në listën e KQZ-së për votim. Edhe në këtë qendër të votimit mungonin udhëzuesit me emrat e partive politike dhe kandidatëve, e që kishte e vështirësuar procesin e votimit, meqë nuk kishin njohuri paraprake për numrat dhe emrat e kandidatëve.*

33. Në Fushë Kosovë procesi zgjedhor është monitoruar në qendrat e votimit si në vijim: qendra e votimit nr. 0905 në fshatin Sllatinë e Madhe; qendra e votimit nr.0903; qendra e votimit nr. nr.0902; qendra e votimit nr. nr.0901; qendra e votimit nr. nr.0909.

Çështjet e evidentuara gjatë monitorimit në Komunën e Fushë Kosovës: *Në disa nga këto qendra të votimit është vërejtur se nuk ka pasur fletëvotime në alfabetin Braille. Është evidentuar se ekipet mobile kanë kryer procesin e votimit në shtëpitë e personave me aftësi të kufizuara. Kamerat e vëzhgimit nuk ishin të vendosur në pozicion të përshtatshëm, e poashtu janë vërejtur edhe shenjzime në listën e kandidatëve të subjekteve politike, të cilat edhe janë raportuar dhe të njëjtat janë zëvendësuar*

34. Në Obiliq procesi zgjedhor është monitoruar në qendrat e votimit si në vijim: qendra e votimit nr.1502 në Milloshevë; qendra e votimit nr. nr. 1502 në Raskovë; qendra e votimit nr.1501; qendra e votimit nr.1510 dhe 1515 në Plemetin; qendra e votimit nr. 1509; qendra e votimit nr. 1503.

*Çështjet e evidentuara gjatë monitorimit në Komunën e Obiliqit: Në këto vendvotime është vërejtur se lista e kandidatëve të subjekteve politike, është e rrumbullakësuar tek kandidatët nga i njëjti subjekt politik. Po ashtu janë evidentuar disa raste të tentimit për ushtrim ndikimi në procesin zgjedhor. Çështja është raportuar dhe lista e kandidatëve të subjekteve politike është zëvendësuar me një të re. Po ashtu është vërejtur se disa qendra të votimit nuk kanë ofruar qasje të përshtatshme infrastrukturore në objekt për persona të moshuar dhe persona me aftësi të kufizuar. Është evidentuar mungesa e shënimit të numrit të qendrës së votimit dhe mungesë e fletvotimeve në alfabetin Braille.*

35. Në Novobërdë procesi zgjedhor është monitoruar në qendrat e votimit si në vijim: qendra e votimit nr.1401 VK, në Llabjan; qendra e votimit nr.1411, në Stanishor; qendra e votimit nr.1404, në Bostan; qendra e votimit nr.1414, në Makresh; qendra e votimit nr.1401, në Novobërdë; qendra e votimit nr.1402, në Llabjan; qendra e votimit nr.1403, në Prekove.

*Çështjet e evidentuara gjatë monitorimit në Komunën e Novobërdës: Është evidentuar se në këto qendra, votimi ka filluar me kohë. Qendrat e votimit kanë qenë të pajisura me tavolinë ndihmëse si dhe vendosja e kamerave ishte bërë në mënyrë të duhur. Kryesisht qendrat e votimit kanë qenë të qasshme për persona me aftësi të kufizuara dhe të moshuarnë aspektin infrastrukturor, e po ashtu kanë qenë të pajisura me fletvotime në alfabetin e Braille, me përjashtim të një qendre të votimit.*

36. Në Kamenicë procesi zgjedhor është monitoruar në qendrat e votimit si në vijim: qendra e votimit nr.1020, në Koretin; qendra e votimit nr.1021 në Petrovc; qendra e votimit nr.1004, në Topanicë; qendra e votimit nr.1022, në Hodonovc; qendra e votimit nr.1018 në Karaçevë e Ulët; qendra e votimit nr.1028 në Karaçevë e Epërme; qendra e votimit nr.1011, në Rogoçicë; qendra e votimit nr.1026, në Muqivërcë; qendra e votimit nr.1027 në Shipashnicë e Poshtme; qendra e votimit nr.1015, në Kolloleq; qendra e votimit nr.1007, në Hogosht; qendra e votimit nr.1025 në Kopernicë; qendra e votimit nr.1001 në Kamenicë; qendra e votimit nr.1002 në Kamenicë.

*Çështjet e evidentuara gjatë monitorimit në Komunën e Kamenicës: Është evidentuar se në këto qendra, votimi ka filluar me kohë, si dhe vendosja e kamerave ishte bërë në mënyrë të duhur. Kryesisht qendrat e votimit kanë qenë të qasshme në aspektin infrastrukturor, me përjashtim të tri qendrave të votimit. Po ashtu, qendrat kanë qenë të pajisura me fletvotime në alfabetin Braille, me përjashtim të dy qendrave të votimit. Gjithashtu është evidentuar se tavolina ndihmëse ka munguar në katër qendra të votimit. Ndërsa mësohet se votimi me asistencë është lejuar vetëm përmes ID-ve, pa kërkim të një dokumenti shtesë.*

37. Në Podujevë procesi zgjedhor është monitoruar në qendrat e votimit si në vijim: qendra e votimit nr.1827 në Obranqë; qendra e votimit nr.1818 në Shajkovc; qendra e votimit nr.1837 në Llugë; qendra e votimit nr.1823 në Orllan; qendra e votimit nr.1805; qendra e votimit nr.1806; qendra e votimit nr. 1839 në fshatin Dyzy; qendra e votimit nr. 1822 në fshatin Tërnavë; si dhe qendra e votimit nr.1801/01 (Burgu i Sigurisë së Lartë) në Dyzy.

Çështjet e evidentuara gjatë monitorimit në Komunën e Podujevës: *Gjatë vëzhgimit të realizuar, nuk është hasur në probleme në procesin e votimit, votimi kryesisht është zhvilluar në formë paqësore. Qendrat e votimit janë hapur në kohën e paraparë dhe janë pajisur me materiale të nevojshme. Qendrat e votimit kanë pasur shenja dalluese për identifikim, po ashtu të vendosura kamerat e sigurisë. Gjithashtu QV kanë qenë të pajisura me fletvotime në alfabetin Braille. Vetëm një nga qendrat e votimit nuk ka pasur qasje të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuar. Në kabinat e votimit janë hasur lista të shënjestuara me emra të kandidatëve të subjekteve politike, të cilët raste janë raportuar dhe janë zëvendësuar listat. Votimi me asistencë është kryer sipas rregullave, asistuesit janë regjistruar në regjistër të veçantë. Në Burgun e Sigurisë së Lartë votimi kishte filluar në orën 10:40. Aty ndodheshin ekipet mobile të KQZ-së, kishte furnizim me materiale zgjedhore dhe votimi realizohej pa pengesa.*

38. Në Mitrovicë Veriore procesi zgjedhor është monitoruar në qendrat e votimit si në vijim: qendra e votimit nr. 3805 - vendvotimet 3805/01; 3805/03; 3805/04; qendra e votimit nr. 3801 - vendvotimet 3801/01; 3801/02; qendra e votimit nr. 3801KV; qendra e votimit nr.3804; qendra e votimit nr.3806; qendra e votimit nr. 3801/02.

Çështjet e evidentuara gjatë monitorimit në Komunën e Mitrovicës Veriore: *Përgjithësisht në këto qendra të monitoruara vërehet se nuk kanë pasur infrastrukturë të përshtatshme për qasjen e personave të moshuar dhe personave me aftësi të kufizuar në qendrat e votimit. Në disa vende është vërejtur se ka munguar fletvotimi në alfabetin Braille. Po ashtu janë identifikuar disa raste të shenjzimeve të numrave të subjekteve politike dhe emrave të kandidatëve tek lista e kandidatëve, për të cilën gjë është raportuar nga zyrtarët e IAP-së dhe janë zëvendësuar listat. Po ashtu pozicionimi i kamerave në vendvotime ka qenë pa standard të unifikuar.*

39. Në Zveçan procesi zgjedhor është monitoruar në qendrat e votimit si në vijim: qendra e votimit nr. 2901 dhe qendra e votimit nr. 2901VK.

Në Leosaviq procesi zgjedhor është monitoruar në qendrat e votimit si në vijim: qendra e votimit nr. 1201/01; qendra e votimit nr.1203 dhe qendra e votimit nr. 1201VK

Në Zubin Potok procesi zgjedhor është monitoruar në qendrat e votimit si në vijim: qendra e votimit nr. 2801VK dhe qendra e votimit nr. 2801VK.

Çështjet e evidentuara gjatë monitorimit në Komunën e Zveçanit, Leosaviqit dhe Zubin Potokut: *Edhe në këto qendra të votimit është evidentuar si problematike qasja infrastrukturale në qendrat e votimit. Disa qendra të votimit kanë raportuar për vonesa në fillimin e procesit të votimit dhe mungesë trajnimesh dhe informacionesh të stafit lidhur me procesin e votimit në përgjithësi. Është evidentuar se ka pasur mungesë të fletvotimeve në raport me numrin e votuesve të regjistruar si dhe mungesë të shenjave treguese në qendrat e votimit.*

### **Gjetjet dhe konstatimet e Avokatit të Popullit**

40. Në përgjithësi sipas vëzhgimit të procesit zgjedhor në terren, nga ekipet e akredituara të IAP, është vërejtur se procesi i votimit është zhvilluar i qetë dhe me rregull. Gjatë monitorimit të procesit mangësitë e evidentuara në proces konsistojnë në: mos unifikimin e praktikave të votimit me asistencë, ku diku është lejuar dhe diku jo pa dëshmi relevante; mungesa e fletvotimeve në Braille në disa qendra të votimit; mungesa e

tavolinave ndihmëse dhe stafit mbështetës për informim dhe orientim të votuesve; mungesa e materialeve informuese nga KQZ në disa vendvotime; mungesa e shenjave orientuese dhe shënimit të numrave të qendrave të votimit në hyrje të tyre; pengesa në qasje infrastrukturore të qendrave të votimit, për persona të moshuar dhe persona me aftësi të kufizuara; mungesa e trajnimeve të mjaftueshme për stafin e angazhuar të KQZ-së në zgjedhje e po ashtu edhe standarde jo të unifikuara të vendosjes së kamerave vëzhguese.

41. Edhe pse përgjithësisht vlerësohet se është respektuar e drejta e votës dhe fshehtësia e saj, e po ashtu edhe vullneti politik i votuesve, megjithatë ekipet e IAP-së kanë hasur në disa parregullsi në disa qendra të votimit sikurse të evidentuara më lart në këtë raport, ku janë hasur broshura/ lista të kandidatëve me subjekte politike të shenjëzuara me numrat e subjekteve politike dhe kandidatëve, e të cilat janë zëvendësuar pas reagimit të ekipeve të IAP-së.
42. Meqenëse njëra nga të gjeturat nga procesi i vëzhgimit të procesit zgjedhor konsiston në mungesën e shenjave orientuese dhe shënimit të numrave të qendrave të votimit në hyrje të tyre, Avokati i Popullit ju sjell në vëmendje se Ligji nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës në nenin 85 specifikon saktësisht informatat që duhet të përmbajë qendra e votimit.
43. Neni 85, paragrafi 3 i ligjit parasheh që: *“Shenjat informuese në ndërtesë duhet të paraqesin në mënyrë të qartë numrin e QV-së. Brenda QV-së, veçanërisht kur ka më tepër se një VV, shenjat për të drejtuar votuesit në VV-në e duhur duhet të paraqiten dukshëm. Secila VV duhet të shënjohej qartë me shenja që tregojnë numrin e VV-së dhe shkronjat nga LPV-ja të atyre votuesve të caktuar në atë VV.”*
44. Lidhur me këtë, po ashtu edhe Rregullorja nr.12/2024 votimi, numërimi në vendvotim dhe menaxhimi i vendvotimit, e miratuar nga KQZ, në nenin 4, paragrafet 3,4 dhe 5 decidivisht përcakton që:  
*“ KQZ sigurohet që të përgatitë shenjat orientuese për informim të votuesve në VV dhe në QV, të cilat janë të dukshme. Menaxheri i QV dhe KVV obligohet që të njëjtat t'i vendosin në hapësirat e dukshme të QV dhe në VV.*  
*Shenjat orientuese për informim të votuesve në QV, përfshijnë, por nuk kufizohen: Emrin dhe kodin e QV; shenjat për të drejtuar votuesin në VV; kodin dhe shkronjat e para të mbiemrave nga LV të VV përkatës; poster me listën e ndalesave, që përfshijnë: ndalimin e armëmbajtjes, fotografimin e votës, votimin familjar.*  
*Shenjat orientuese për informim të votuesve në VV, përfshijnë, por nuk kufizohen: Kodin dhe shkronjat e para të mbiemrave nga LV të VV përkatës; shenjat për të drejtuar votuesin gjatë procesit të votimit; poster me listën e ndalesave që përfshijnë: ndalimin e armëmbajtjes, fotografimin e votës, votimin familjar.”*
45. Gjatë monitorimit të procesit po ashtu është vërejtur se ka pasur mungesë të tavolinave ndihmëse në qendrat e votimit si dhe të stafit të trajnuar për orientimin dhe informimin e votuesve. Është vërejtur se nuk ka pasur praktika të unifikuara të vendosjes së tavolinave ndihmëse në qendrat e votimit. Ato nuk kanë qenë të vendosura në secilën qendër të votimit, diku ka pasur dhe diku jo si dhe është evidentuar mungesë të materialeve informuese në disa prej qendrave të votimit

46. Sa i përket të identifikuarave si më lart, Avokati i Popullit vëren se Rregullorja zgjedhore nr. 05/2024 mbi themelimin dhe menaxhimin e qendrave të votimit në nenin 8, paragrafet 1,2,3, dhe 4 lidhur me tavolinat ndihmëse në qendrat e votimit parasheh që:

*“Në hyrjen kryesore të çdo QV duhet të vendoset së paku një tavolinë ndihmëse që shërben për orientimin dhe informimin e votuesve. Tavolina ndihmëse duhet të jetë e pajisur me LV në formatin elektronik. Tavolina ndihmëse duhet të jetë e pajisur me formularët për ankesa dhe parashtrësia që i drejtohen PZAP, nëpërmjet të cilave votuesit mund të ankohen në PZAP gjatë ditës së votimit në rast se kanë vërejtje. Çdo QV duhet të ketë personelin e tavolinës ndihmëse, i cili është përgjegjës për: Orientimin e votuesve në vendvotime, sipas LPV; raportimin e pjesëmarrjes së votuesve; raportimin e rezultateve preliminare, bazuar në të dhënat e KVV, sipas udhëzimeve nga KQZ.”*

Po ashtu, neni 6 paragrafi 2 dhe 3, i kësaj rregulloreje parasheh që: *“Personeli i QV përbëhet nga: Menaxheri i QV dhe personeli i tavolinës ndihmëse. Menaxheri i QV, është përgjegjës për: Organizimin dhe planifikimin e të gjitha aktiviteteve teknike në QV; pranimin e pakos së materialeve jo të ndjeshme të QV; orientimin, qarkullimin dhe qasjen e votuesve në QV; raportimin tek KKZ, për mbarëvajtjen dhe gjendjen në QV; evidentimin në librin e evidencës, si Shtojcë V – Libri i evidencave.”*

47. Sa i përket votimit me asistencë, Avokati i Popullit vëren se procedura e votimit me asistencë nuk është zbatuar me konsistencë. Respektivisht në disa raste votuesit ishin lejuar të asistoheshin pa dokumentacionin e kërkuar dhe nëse disa raste nuk ishin lejuar.

48. Lidhur me votimin me asistencë Ligji nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, në nenin 89, paragrafet 1, 5 dhe 6 parasheh se:

*“Votuesi me të drejtë për të votuar ka të drejtë vote nëse ai/ajo është i regjistruar në Kosovë ose ka aplikuar suksesshëm për votim jashtë Kosovës siç përcaktohet në nenet 6 dhe 7 të këtij ligji ..... Votuesi i cili është me aftësi të kufizuara në atë mënyrë që nuk është në gjendje të shënojë ose hedh fletëvotimin, mund të ndihmohet nga një person tjetër i zgjedhur nga votuesi, me kusht që personi që ndihmon është votues në qendrën e njëjtë të votimit me votuesin. Personi i tillë e ndihmon vetëm një votues dhe nuk është anëtar i KVV-së ose vëzhgues i akredituar, përjashtimisht për anëtarët e ngushtë të familjes. Për këtë lloj të votimit, KQZ do t'i caktojë kriteret me rregullën zgjedhore. Kryesuesi i Këshillit të vendvotimit obligohet që të shënojë në librin e votimit, rastet e votimit me asistencë, duke përfshirë arsyet konkrete dhe të shënojë të dhënat personale të votuesit dhe të dhënat personale të personit që ka ndihmuar.”*

49. Lidhur me këtë po ashtu neni 10, paragrafet 5 dhe 6 të Rregullores zgjedhore nr. 12/2024 përcakton që:

*“Votuesi i cili është me aftësi të kufizuara në atë mënyrë që nuk është në gjendje të shënojë ose hedh fletëvotimin, kur aftësia e tij e kufizuar dëshmohet përmes dokumenteve përkatëse, mund të ndihmohet nga një person tjetër (asistuesi) nga e njëjta QV, i zgjedhur nga votuesi, duke ndjekur procedurën e mëposhtme: Personi që asiston duhet të jetë i moshës 18 vjeç dhe të ketë një nga dokumentet e identifikimit të Republikës së Kosovës, si në nenin 11 të kësaj Rregullore; asistuesi e ndihmon vetëm një votues dhe nuk është anëtar i KVV ose vëzhgues i akredituar; në rastin kur personi i asistuar nuk është në gjendje fizike të nënshkruaj atëherë asistuesi shkruan në LV “PËR: emrin dhe*

*mbiemrin e tij”, në hapsirën e votuesit që është asistuar; kryesuesi i KVV shënon në Librin e Votimit numrin rendor, kohën, të dhënat personale të votuesit dhe të asistuesit si dhe arsyen e saktë të votimit me asistencë. Numri i rastit në Librin e Votimit shënohet në hapësirën e votuesit në LV; asistuesi mund ta ndihmojë në votim personin me aftësi të kufizuar, duke ia mbajtur dorën dhe mundësuar që votuesi të shënjoj vetë fletvotimin. Në rast se votuesi nuk mund ta hedhë fletvotimin në kuti, atëherë asistuesi e ndihmon këtë proces.*

*Nëse votuesi është i verbër, udhëzohet që të votojë në mënyrë të pavarur, përmes shabllonit me alfabetin e brail-it, që gjendet në tavolinën ndihmëse në QV. Në rast se votuesi i verbër nuk di të përdor alfabetin e brail-it, atëherë aplikohen procedurat sipas paragrafit 5 të këtij neni.”*

50. Ndonëse e drejta e votimit është e garantuar në mënyrë të barabartë për ushtrim nga të gjithë qytetarët e vendit, ekipet monitoruese të IAP-së kanë vërejtur se nuk ka pasur praktikë të unifikuar të vendosjes së fletvotimeve në alfabetin Braille në Qendrat e Votimit. Janë identifikuar shumë qendra të votimit që nuk e kanë poseduar fletvotimin në alfabetin braille.
51. Lidhur me përdorimin e fletvotimeve në alfabetin braille, Rregullorja nr.05/2024 mbi themelimin dhe menaxhimin e qendrave të votimit, në nenin 8, paragrafin 5 përcakton që: *“Në çdo QV duhet të ketë edhe shabllone me alfabetin e brail-it dhe KVV të trajnuar për votimin e personave të verbër, të cilët do t’u shërbejnë votuesve të verbër në atë QV.”*
52. Ekipet e IAP-së po ashtu kanë vëzhguar procesin e votimit të qytetarëve me nevoja të veçanta, përkatësisht kanë monitoruar procesin zgjedhor në qendrat e ndalimit dhe të paraburgimit, qendrat korrektuese, shtëpitë e të moshuarve, institucionet e shëndetit mendor dhe qendrat e hospitalizimit. Me qëllim të vëzhgimit të mbarëvajtjes së procesit të votimit dhe respektimit të të drejtave të qytetarëve për votim, ekipet e IAP-së kanë vizituar: Shtëpinë për Përkujdesje të të Moshuarve në Prishtinë; Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK); Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë (QPP); Qendrën e Paraburgimit në Pejë; Qendrën Integruese në Bashkësi si dhe Spitalin Regjional në Pejë; Qendrën Korrektuese në Dubravë; Shtëpinë e Komunitetit për Persona të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Gurrakoc të Istogut; Spitalin e Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë dhe Shtëpinë e Integruar në Bashkësi në Gjakovë; Qendrën Korrektuese në Smrekonicë; Qendrën e Paraburgimit në Prizren; Shtëpinë integruese në Bashkësi si dhe Qendrën e Ndalimit në Ferizaj; Qendrën Integruese Rehabilituese e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik në Shtime; Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan; Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan si dhe Burgun e Sigurisë së Lartë në Dyç.
53. Në përgjithësi është vërejtur se procesi i votimit në këto qendra ka shkuar me rregull, me përjashtim të disa mangësive të vërejtura në disa prej tyre. *Sa i përket Qendrës Integruese në Bashkësi në Pejë, ekipi i IAP gjatë vizitës në këtë qendër është njoftuar se qendra ka 9 rezidentë me të drejtë vote, por të cilët nuk kanë mundur të votojnë, për arsye se nuk janë vizituar nga ekipet e KQZ me qëllim të votimit. Në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, nga 70 të paraburgosur, të regjistruar për votim janë evidentuar 66. Gjatë monitorimit të procesit të votimit, fillimisht është vërejtur se KQZ nuk e kishte sjellur materialin e kompletuar dhe sipas komunikimit të mëvonshëm me*

qendrën, ekipet e IAP-së janë njoftuar se votimi në këtë qendër ka filluar në ora 11:00 dhe procesi kishte shkuar me rregull.

Sa i përket Shtëpisë Integruese në Bashkësi në Ferizaj, kanë qenë të regjistruar 10 persona për votim dhe deri në kohën kur ekipet e IAP-së kanë monitoruar procesin nuk është zhvilluar votimi. Ndërsa më vonë sipas informatave që IAP ka pranuar nga KKZ në Ferizaj, është njoftuar se edhe pse informatat e nevojshme u janë përcjellur KQZ-së, nuk është marrë asnjë instruksion apo udhëzim për veprim lidhur me mundësimin e votimit të tyre.

Sa i përket Qendrës së Paraburgimit në Gjilan, procesi i votimit kishte filluar në ora 11:37, për shkak të disa vonesave teknike dhe administrative. Në këtë qendër po ashtu procesi ka shkuar me rregull, ndërsa 4 (katër) personave nuk iu është lejuar votimi për shkak se nuk gjendeshin në listën e votuesve. Ndërsa në Qendrën Integruese Rehabilituese e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik në Shtime (QIRSKP), rezidentëve nuk i'u është mundësuar e drejta e votimit. Në këtë vendvotim prej 61 rezidentëve, të drejtë vote kishin 21 rezidentë (prej 21 rezidentëve, 4 ishin në familje – në vikend terapeutik). Rezidentët votojnë të gjithë me asistencë. 3 prej tyre kanë refuzuar votimin. Disa nga rezidentët nuk kanë mundësi votimi, për shkak të mungesës së dokumenteve.

Në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan, 3 të miturve të burgosur, nuk i'u është mundësuar e drejta e votimit, për shkak se nuk kanë qenë të evidentuar në listë të KQZ-së. Sipas informatave të pranuar tek Qendra Korrektuese për të Mitur të drejtë votimi kanë pasur 25 të burgosur të mitur. Në Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan, dy të burgosurave, nuk i'u është mundësuar e drejta e votimit, edhe pse kanë qenë në listën e burgut. Në QKM dhe QKF në Lipjan, ka munguar udhëzuesi me emrat e partive dhe të kandidatëve, pasi që ekipet mobile të KQZ-së kanë poseduar vetëm udhëzuesin me alfabet Braille.

54. Lidhur me rregullat për votimin e personave me nevoja të veçanta, Avokati i Popullit ju sjell në vëmendje se, sipas neni 99 i Ligjit nr. 08/L-228 për zjedhjet e përgjithshme përcaktohet se: “KQZ-ja përcakton rregullat për votim për personat me nevoja të veçanta: 1.1. votuesit me të drejtë vote të cilët nuk mund të dalin nga shtëpitë e tyre për të votuar personalisht në vendvotimin e zakonshëm për shkak të paafësisë fizike, mjekësore ose çfarëdo paafësie tjetër; 1.2. votuesit me të drejtë vote, me lëvizje të kufizuar në ndonjë institucion: votuesit në hospitalizim, njerëzit e moshuar në shtëpitë e caktuara veçanërisht për të moshuarit, personat në trajtim në institucionet e shëndetit mendor, të burgosurit në burgje dhe të paraburgosurit në qendrat e paraburgimit; 1.3. votimi në rrethana të veçanta: votuesi që për shkaqe sigurie dhe votuesit që janë në arrest shtëpiak, nuk mund të votojnë në vendvotimin e tyre të caktuar. Për këtë lloj votimi, Komisioni Komunal i Zgjedhjeve ndërmer të gjitha veprimet për regjistrimin dhe miratimin e këtyre kategorive të votimit.”
55. Sa i përket regjistrimit të votimit të personave me nevoja të veçanta, KQZ ka miratuar Rregulloren zgjedhore nr.09/2024 për regjistrimin dhe votimin e personave me nevoja të veçanta, e cila rregullore përcakton mënyrën e regjistrimit, evidentimit dhe votimit të personave me nevoja të veçanta (VPNV) në ditën e zgjedhjeve, nga Komisioni i Votimit të Ekipit Lëvizës (KVEL), të organizuara nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ), në komunën përkatëse.

56. Rregullorja zgjedhore nr. 09/2024, përkitazi me regjistrimin e votuesve me nevoja të veçanta, në nenin 2 të saj përcakton se:

*“Votues me nevoja të veçanta, konsiderohen votuesit me zotësi juridike që nuk mund të dalin nga shtëpitë e tyre për të votuar personalisht në vendvotim (VV), për shkak të paaftësisë fizike, shëndetësore ose çfarëdo paaftësie tjetër. Votuesi me zotësi juridike, i cili dëshiron të regjistrohet si votues me nevoja të veçanta, duhet të aplikojë për regjistrim përmes platformës elektronike ose fizikisht në zyrët e KKZ përkatëse. Kërkesa për regjistrim, bëhet duke bashkangjitur dokumentet, si në vijim: Njërën nga dokumentet e vlefshme të identifikimit: letërnjoftim, pasaportë apo lejen e vozitjes); një kopje të certifikatës së paaftësisë, diagnozës mjekësore, ose dëshmi tjetër relevante në mbështetje të aplikimit të tij/saj; fotografën e votuesit me dokumentin identifikues në dorë. Organizatat joqeveritare (OJQ) të cilat janë të regjistruara dhe të specializuara për ndihmë personave me nevoja të veçanta, mund të pranojnë formularë dhe dokumentet sipas kërkesave në paragrafin 3 të këtij neni dhe ti dorëzojnë ato në KKZ me autorizim të noterizuar të aplikantëve.”*

57. Gjithashtu kjo rregullore ka paraparë edhe regjistrimin e votuesve në institucione të ndalimit, në hospitalizim e në shtëpi të të moshuarve.

Rregullorja 09/2024, në nenin 3, paragrafet 1,2,3 dhe 4 ka paraparë që: *“Votues në institucione konsiderohen votuesit me zotësi juridike, me lëvizje të kufizuar në ndonjë institucion: votuesit në hospitalizim, njerëzit e moshuar në shtëpitë e caktuara për të moshuarit, personat në trajtim në institucionet e shëndetit mendor, të burgosurit në burgje dhe të paraburgosurit në qendrat e paraburgimit. KQZ, përmes memorandumeve të bashkëpunimit me institucione relevante, bën evidentimin e këtyre votuesve. KKZ identifikon institucionet e përcaktuara sipas paragrafit 1 të këtij neni brenda komunës së vet. Shërbimi i votueseve (SHV) në bashkëpunim me administratën e institucioneve, bën evidentimin e të gjithë qytetarëve me të drejtë vote në këto institucione, jo më vonë se 10 ditë para ditës së zgjedhjeve. Kjo evidencë duhet të përfshijë këto të dhëna: emrin dhe mbiemrin, datën e lindjes, numrin personal, gjininë dhe numrin e telefonit, nëse e ka. SHV, organizon regjistrimin e votuesëve në: Institucionet e hospitalizimit; shtëpitë e të moshuarëve; strehimoret për mbrojtjen e viktimave”.*

58. Gjatë monitorimit të procesit zgjedhor nga ekipet e IAP-së, një tjetër çështje sfiduese për votuesit është identifikuar edhe paqasshmëria infrastrukturore apo fizike e disa qendrave të votimit, e që kanë penguar dhe vështirësuar ushtrimin e së drejtës së votës për persona me aftësi të kufizuar dhe persona të moshuar me vështirësi në lëvizje.

59. Rregullorja zgjedhore nr. 05/2024 themelimi dhe menaxhimi i qendrave të votimit, në nenin 2, paragrafin 2 lidhur me qendrat e votimit dhe vendndadhjen e tyre përcakton: *“Qendrat e Votimit themelohen në: 2.1. Ndërtesa të institucioneve publike, me prioritet në objektet arsimore, kulturore, sportive dhe të ngjashme; 2.2. në përfaqësi diplomatike të Republikës së Kosovës, për votim jashtë vendit për zgjedhjet parlamentare.”*

60. Sa i përket kriterëve që duhet të plotësojnë objektet e qendrave të votimit, neni 3, paragrafi 1 i kësaj rregulloreje parasheh që: *“Objektet e QV duhet t'i plotësojnë kushtet si në vijim: 1.1. Të ketë së paku një hyrje, e cila duhet të jetë lehtësisht e qasshme; 1.2. të ketë ndriçim të mjaftueshëm; 1.3. të ketë qasje të lehtë për votim të personave me nevoja të veçanta; 1.4. të ketë tavolina dhe karrige; 1.5. të ketë energji elektrike; 1.6. të ketë*

internet; 1.7. të ketë së paku një tualet; 1.8. për aq sa është e mundur, të ketë hapësirë për parking”.

61. Rregullorja nr. 05/2024 në nenin 9, paragrafin 1 lidhur me vendndodhjen e vendvotimeve përcakton që: *“Vendvotimet vendosen duke filluar në katin përdhësë, në një vend të përshtatshëm për hyrje-dalje, për t’u mundësuar votuesve të krijojnë rresht dhe të qëndrojnë në të, dhe kur është e mundur, vendi për hyrje-dalje të jetë i rrafshët, ashtu që personat me aftësi të kufizuara të mund të hyjnë dhe të dalin në mënyrë të papenguar.”*
62. Po ashtu edhe Rregullorja zgjedhore nr. 12/2024 votimi, numërimi në vendvotim dhe menaxhimi i vendvotimit, lidhur me vendvotimin dhe vendndodhjen, në nenin 2, paragrafi 1 përcakton se: *“VV vendosen duke filluar në katin përdhësë, në një vend të përshtatshëm për hyrje-dalje, për t’u mundësuar votuesve të krijojnë rresht dhe të qëndrojnë në të dhe kur është e mundur vendi për hyrje-dalje të jetë i rrafshët, ashtu që personat me nevoja të veçanta të mund të hyjnë dhe të dalin në mënyrë të papenguar”.*
63. Avokati i Popullit po ashtu ju risjell në vëmendje se edhe Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Protokolli Opsional, në Nenin 29 [Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike] garanton mbrojtjen e së drejtës për të zgjedhur dhe për tu zgjedhur ashtu që e njëjta ndër shumë çështje parasheh edhe obligimin e shteteve që *tu garantojnë personave me aftësi të kufizuara pjesëmarrjen e plotë dhe efektive në jetën politike dhe publike ndër të tjera duke:*
- (i) Siguruar që procedurat, facilitetet dhe materialet e votimit të jenë të përshtatshme, të aksesueshme dhe të thjeshta për tu kuptuar dhe përdorur;*
  - (ii) Mbrojtur të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të votuar me votë të fshehtë në zgjedhje dhe referendume publike, pa kërcënim, për të kandiduar në zgjedhje, për të ushtruar funksione publike dhe për të kryer të gjitha funksionet publike në të gjitha nivelet e qeverisë, duke lehtësuar përdorimin e teknologjive asistuese dhe të reja, ne rastet e përshtatshme;*
  - (iii) Garantuar shprehjen e vullnetit të lirë të personave me aftësi të kufizuara si zgjedhës dhe për këtë qëllim, kur është e nevojshme, me kërkesën e tyre, lejohet asistenca në votim nga një person i zgjedhur prej tyre.*
- (b) garantimin e një ambjenti, në të cilin personat me aftësi të kufizuara mund të marrin pjesë në mënyrë efektive dhe të plotë në dirigjimin e çështjeve publike, pa diskriminim dhe njësoj si të tjerët dhe të inkurajojë pjesëmarrjen e tyre në çështjet publike....”*
64. Në rastin *Toplak dhe Mrak kundër Sllovenisë* (2021) që përfshinte dy qytetarë përdorues të karrocave, të cilët u përballën me sfida për të hyrë në qendrat e votimit gjatë një referendumi, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) vendosi se Sllovenia shkeli të drejtat e tyre duke mos ofruar vendvotime të aksesueshme ose teknologji ndihmëse të votimit paraprakisht. Gjykata theksoi se individët me aftësi të kufizuara kanë të drejtë në qasje adekuate në qendrat e votimit për të siguruar shprehjen e lirë dhe të fshehtë të vullnetit të tyre.
65. Avokati i Popullit në disa raporte paraprake me rekomandime pati ngritur dhe analizuar problematikën e qasshmërisë së objekteve publike si dhe të hapësirave publike. Duke pasur parasysh se procesi i votimit realizohet në objekte të institucioneve publike,

kryesisht në shkolla, Avokati i Popullit ju sjell në vëmendje se më 26 dhjetor të vitit 2023 pati publikuar Raportin me rekomandime ex officio nr. 479/2022,<sup>1</sup> në lidhje me vlerësimin e qasshmërisë për personat me aftësi të kufizuara bazuar në Udhëzimin Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në komunat e Republikës së Kosovës dhe ku ka adresuar rekomandime për të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, lidhur me zbatimin e kushteve teknike për qasshmërinë e objekteve për persona me aftësi të kufizuara.

66. Po ashtu më 23 shtator 2023, Avokati i Popullit ka publikuar Raportin me rekomandime Ex officio nr. 648/2021<sup>2</sup> në lidhje me qasjen në trotuare, hapësira publike dhe lëvizjen e lirë të qytetarëve si dhe respektimin e së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm jetësor, ku përveç hapësirave publike si trotuareve dhe vendkalimeve për këmbësorë, është bërë edhe vlerësimi i qasshmërisë së hyrjeve të shkollave, veçanërisht për persona me aftësi të kufizuara dhe janë dhënë rekomandime konkrete në përmirësimin e qasjes.
67. Avokati i Popullit po ashtu ka përcjellur me shqetësim rastet e raportuara të cënimit të fshehtësisë së votes dhe vullnetit politik të qytetarëve. Sikurse është përmendur edhe më lart, në disa qendra të votimit, në kabinat e votimit janë identifikuar lista të shënjuara me numra të subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre. Përkitazi me këtë Avokati i Popullit sjell në vëmendje nevojën për angazhim të shtuar të institucioneve kompetente për mbrojtjen e fshehtësisë së votës dhe parandalimin e cënimit të vullnetit të lirë politik të qytetarëve, ashtu siç është përcaktuar në parimet themelore sipas Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme.
68. Ligji nr. 08/L-228 në nenin 4, paragrafin 1.3 përcakton që: *“liria dhe fshehtësia e votës është e garantuar. Askush nuk ka të drejtë të pengojë ndonjë qytetar për të votuar, të detyrojë atë të votojë në një mënyrë të caktuar, të mbajë atë përgjegjës për votën, ose të kërkojë kundër dëshirës së tij/saj që të zbulojë votën e tij/saj ose arsyet për mos votim.”*
69. Po ashtu e drejta e votës dhe fshehtësia e saj është e garantuar me nenin 89, paragrafet 4 dhe 10 të ligjit të lartpërmendur, ku shprehimisht përcakton: *“Secili votues e plotëson fletëvotimin e vet në fshehtësi mbrapa kabinës së votimit. Vetëm një person lejohet mbrapa kabinës së votimit gjatë një intervali të caktuar kohor përveç nëse votuesi ka kërkuar ndihmë nga personi tjetër, siç përcaktohet në paragrafin 5 të këtij neni..... Anëtarët e KVV-së kujdesen veçanërisht për të siguruar që zgjedhësi nuk shqetësohet nga askush përderisa shënjon fletën e tij të votimit, dhe se fshehtësia e votimit është plotësisht e siguruar.”*

## Përfundim

Avokati i Popullit vlerëson se zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës të mbajtur më 9 shkurt 2025, janë zhvilluar në një ambient të qetë dhe demokratik, ku përgjithësisht janë respektuar të drejtat zgjedhore dhe vullneti politik i qytetarëve të vendit.

<sup>1</sup> Për më tepër shih raportin e publikuar në ueb faqen e IAP-së: <https://oik-rks.org/2023/12/29/raport-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-4792022-ne-lidhje-me-vleresimin-e-qasshmerise-per-personat-me-aftesi-te-kufizuara-bazuar-ne-udhezimin-administrativ-nr-332007-per-kushtet-teknike-te-o/>

<sup>2</sup> Për më tepër shih raportin e publikuar në ueb faqen e IAP-së: <https://oik-rks.org/2023/09/25/raport-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-6482021-ne-lidhje-me-qasjen-ne-trotuare-hapesira-publike-dhe-levizjen-e-lire-te-qytetareve-si-dhe-respektimin-e-se-drejtës-per-mjedis-te-sigurt-dhe-te-s/>

Procesi zgjedhor ka një rëndësi të veçantë për vendin në forcimin e demokracisë dhe stabilitetit në vend.

E drejta e votës është një e drejtë e garantuar dhe zgjedhjet janë një mundësi për qytetarët, që të shprehin vullnetin e tyre politik dhe të përcaktojnë udhëheqësit e ardhshëm, duke kontribuar kështu në forcimin e institucioneve demokratike. Mbi të gjitha, ky proces ofron një mundësi për të siguruar që autoritetet e zgjedhura reflektojnë vullnetin e popullit dhe janë të përgjegjshme ndaj atij vullneti.

KQZ dhe institucionet tjera përkatëse, përfshirë ato të sigurisë kanë marrë masa të duhura për të siguruar që procesi zgjedhor të zhvillohet në mënyrë të qetë, demokratike dhe të sigurt.

Avokati i Popullit vlerëson se, përtej rezultateve pozitive të këtij procesi ende ka hapësira për përmirësim. Një nga aspektet e evidentuara për përmirësim është edhe nevoja për fuqizimin e kapaciteteve të personelit të KQZ-së të angazhuar në terren, përkitazi me mbarëvajtjen e procesit zgjedhor dhe për të qenë në gjendje që të përmbushin përgjegjësitë e tyre në mënyrë adekuate. Veçanërisht përforcimi i kapaciteteve të personelit të angazhuar në qendra të votimit duhet të fokusohet në menaxhimin efikas të procesit zgjedhor si dhe në sigurimin e mbarëvajtjes së procesit zgjedhor, e cila po ashtu do të kontrobonte në orientimin dhe informimin sa më adekuat dhe të saktë nga ana e tyre e qytetarëve votues, në mënyrë që ata të mund të ushtrojnë të drejtën e votës në mënyrë të informuar dhe të qartë.

Po ashtu, është e nevojshme një angazhim dhe kujdes i shtuar në garantimin e ushtrimit të së drejtës së votës për qytetarët me aftësi të kufizuara. Kjo përfshinë fuqizimin e përpjekjeve dhe kujdesin e shtuar në caktimin e qendrave të votimit të qasshme për të gjithë. Angazhimi i institucioneve të shtetit për këtë kategori të qytetarëve është një element kyç për të siguruar që zgjedhjet të jenë gjithpërfshirëse dhe të barabarta për çdo qytetar të Kosovës.

Një tjetër çështje që kërkon vëmendje është unifikimi i praktikave në zbatimin e rregullave dhe procedurave zgjedhore të caktuara me ligj dhe me rregulloreve zgjedhore në lidhje me realizimin e zgjedhjeve, realizimin e të drejtës së votës me asistencë, të drejtës së votës për qytetarët me nevoja të veçanta si dhe asistimin nga ekipet mobile. Gjithashtu si e nevojshme shihet edhe unifikimi i praktikave në monitorimin dhe vëzhgimin e procesit zgjedhor si dhe sigurimin e mbikëqyrjes së respektimit të fshehtësisë së votës dhe vullnetit politik të qytetarëve.

Këto dhe të gjetura të tjera të paraqitura në raport duhet të shërbejnë si bazë për përmirësimin e mëtejshëm të procesit zgjedhor dhe për forcimin e respektimit të së drejtës për zgjedhje në të ardhmen.

Evitimi i çfarëdo mangësie eventuale në proces do të mundësojë dhe do të reflektojë një proces më të efektshëm dhe më të besueshëm duke garantuar integritetin e zgjedhjeve dhe besimin e qytetarëve në sistemin zgjedhor në Kosovë.

Me nderime,

Naim Qelaj  
Avokat i Popullit